



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturu Omiladinu i Sport
Department of Culture Youth and Sports

Thirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe Individive në fushën e Kulturës.

1. Komuna e Skenderajit përkatësishtë Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Komunën e Skenderajit, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës në Komunën e Skenderajit.
 2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte /programet e tyre për aktivitetin kulturor historik, i paraparë me Rregulloren Komunale për ndarjen e subvencioneve nr.01-400/01-0051689/20 të dt. 04.12.2020 siç është **Festivali Folklorik “Rapsodia Shqiptare”** që njihet si aktiviteti kryesor tradicional i Komunës së Skenderajit në datat **26,27 dhe 28 Nëntor**.
 3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të kulturës i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktivitetit tradicional të paraparë me pikën 2 të kësaj thirrje publike.
 4. Shuma e mbështetjes financiare është **19,200.00 Euro**.
- Vlera totale e thirrjes publike është **19,200.00 Euro**.
5. **Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 23/09/2024, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën 11/10/2024.**

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Skenderajit dhe të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike, periudha e zbatimit të projektit është fundi i vitit aktual.

OJQ-të aplikuese duhet të deshmojnë se programi i tyre punës është i fokusuar në fushën e kulturës, si dhe të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore. Nëse kanë qenë përfitues e mjeteve financiare të ndara nga Komuna Skenderaj, të justifikojnë mjetet e shpenzuara duke dorëzuar raportin financiar.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të paguara, nëse është e aplikueshme. Të njëjtat dëshmi duhet të I dorëzojë edhe personi fizik i cili është përfitues i mbështetjes financiare.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Skenderajt kk.rks-gov.net/Skenderaj.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në zarf të mbyllur në arkivën e komunës në adresën: **“Komuna Skenderaj, ruga 28 Nentor 41000” - Skenderaj**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në **Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike**. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e percaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: komuna.skenderaj@rks-gov.net.

Skenderaj, 23.09.2024

Drejtori:

Alban Berisha

